



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-23-0111

Në ankesën e

Paditësja/Ankuesja

N P, Prizren.

kundër

E paditura/Ankuesja

NSH. "Lavërtari dhe Blegtori" , Prizren (në likuidim) të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. " Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Agron Hoxhaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses dhe të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-22-0361 të datës 02 shkurt 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 11 janar 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesat refuzohen si të pa bazuara.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-22-0361 të datës 02 shkurt 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 07 prill 2015, paditësja përmes postes e dërgoi në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit, të NSH-së "Lavërtari dhe Blegtori" , Prizren (në likuidim), PRZ009-0255 të datës 06 mars 2015, me të cilin kërkesa e paditësit e datës 19 gusht 2014, për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga viti 2004-2013, në shumë prej 9.765,67 euro refuzohet si e pa vlefshme me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Në ankesë paditësja ka pohuar se me vendimin e ankimuar nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike e po ashtu gabimisht është aplikuar edhe e drejta materiale kur është zbatuar neni 608 i Ligjit të Punës së Bashkuar. Paditësja pohon se Autoriteti i Likuidimit nuk e ka vërtetuar faktin vendimtar se a është ndërprerë parashkrimi me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës duke pohuar se ka pushuar së rrjedhuri afati i parashkrimit. Ajo pohon se në këtë rast kemi të bëjmë me pranim të borxhit pasi që janë paguar këstet e pagave në formë të akontacionit prej vitit 2004 e deri në vitin 2013, e kjo paraqet një pranim të borxhit, andaj nuk ka ndodhë parashkrimi siç konstaton Autoriteti i Likuidimit. Bashkë me ankesë paditësja ka bashkangjitur, vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, formularin e kërkesës, listë të pagave të pa nënshkruara, të pa protokolluara dhe të pa vulosura, një raport të rrjedhës bankare të llogarisë në R B.

Me datë 11 qershor 2021, AKP-ja e ka dorëzuar në DHPGJS, mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja ka pohuar se ankesa nuk i përmban kriteret e pranueshmërisë si parashihen në nenin 74.2 të LDHP. Tutje AKP-ja pohon se paditësja ka dështuar të tregoj se cili nen i Ligjit të AKP-së është shkelur në vendimin e ankimuara të Autoritetit të Likuidimit, duke pohuar se ky vendim nuk është në kundërshtim me asnjë dispozitë të Ligjit të AKP-së. AKP-ja pohon se kërkesa për kompensimin e pagave për përdhën 2004-2013 është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, pasi që paditësja nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi të i ketë kërkuar këto paga në afat prej tri viteve pranë ndonjë gjykate kompetente.

Me datë 13 korrik 2021, paditësja e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë dhe përgjigjet në mbrojtën e AKP-së. Në këtë parashtresë paditësja pohon se e paditura gabimisht po pretendon se ka ardhur deri te parashkrimi i kërkesës për pagat e pa paguara nga ana e NSH-së. Bazuar në nenin 387 të LMD-së ndërpritet parashkrimi kur debitori e pohon borxhin. E paditura gjatë periudhës kontestuese 2004-2013, ka bërë pagesat e pagave në formë të akontacionit, kohë pas kohe dhe se me pagesat e tilla ajo e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës. Një fakt i tillë vërtetohet nga rrjedha e llogarisë bankare të paditëses në Raiffaisen Bnak, e cila ndodhet në shkresat e lëndës. Tutje paditësja pohon se asaj i është ndërprerë marrëdhënia e punës me datë 06.09.2013, kur është mbyllë Libreza e punës dhe kur asaj i është dërguar Njoftimi i AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Bashkë me këtë parashtresë paditësja dorëzon provat e reja, Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 06.09.2013, kopjen e Librezës së punës e mbyllur me datë 06.09.2013, një kopje të një vendimi tjetër të Autoritetit të Likuidimit PRZ009-0251 me të cilin asaj pjesërisht i është aprovuar kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës si dhe vendimin PRZ009-0249, me të cilën asaj pjesërisht i është pranuar kërkesa për 3 pagat e pa paguara, dhe një Aktgjykim të DHPGJS-së të Shkallës së I-rë e cila i referohet një pale tjetër.

Me datë 12 gusht 2021, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS kundërpërgjigjen, në të cilën ajo i përsërit pretendimet e veta të cekura në mbrojtjen në ankesë.

Me datë 19 tetor 2021, Shkalla e parë e DHPGJS ankesën e paditëses e refuzon si të pa bazuar dhe e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e I-rë e DHPGJS ka arsyetuar se kërkesa e paditëses për kompensimin e pagave për periudhën nga 2004 e deri në vitin 2013, nuk është mbështetur me prova të mjaftuara, andaj është dashtë të refuzohet si e pa bazuar. Shkalla e I-rë konstaton se për periudhën e cekur pagat ishin kryer përmes llogarisë bankare për qka paditësja ka dorëzuar ekstraktin e llogarisë bankare të Raiffaisen Bnak. Të gjitha pagesat që janë bërë tani paditëses përmes llogarisë bankare janë evidentuar si pagesa për paga e jo si akontacion apo këst

në emër të pagës. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se paditësja në mbështetje të kërkesës për paga ka bashkangjitur një listë të pagave për vitet 2004-2013, e cila nuk konsiderohet se është dokument provues për faktin se nuk dihet se kush është hartues i këtij dokumenti dhe nuk është dokument zyrtar i evidentuar tek e paditura. Sipas këtyre llogaritjeve – kalkulimi të pagave të pretenduara rezulton se janë llogaritë paga edhe për periudhën kohore pas datës së fillimit të procedurës së likuidimit, ndërsa dihet se data e ndërprerjes së kontratës së punës ishte me 09.06.2013. Paditësja në mbështetje të kërkesës së saj kreditore nuk dorëzoi asnjë provë në mbështetje të kërkesës, përtej asaj që është pranuar dhe paguar nga e paditura. Nuk është kontestuese se e paditura ishte në marrëdhënie pune deri në ditën e fillimit të procedurës së likuidimit, por kontestuese është kërkesa e paditëses në emër të pagave të pa paguara, përtej 3 pagave për të cilat Autoriteti i Likuidimit ka marrë vendim që ti pranohet kërkesa dhe po ashtu Autoriteti i Likuidimit ka marrë vendim që në emër të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës ti paguhet 3 paga. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se nuk ka asnjë dëshmi që e paditura i detyrohet paditëses për ndonjë borxh në emër të pagave të pa paguara për periudhën e cekur kohore, përtej asaj që e paditura në vazhdimësi i ka paguar paditëses nëpërmes llogarisë bankare. Shkalla e I-rë po ashtu konstaton se paditësja nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi që të ketë iniciuar ndonjë procedurë për pagat e pretenduara të periudhës 2004-2013, para ndonjë organi kompetent për realizimin e këtyre të drejtave, po ashtu nuk janë dorëzuar as lista valide të pagave sipas të cilave do të bëhej pagesa.

Me datë 24 nëntor 2021, paditësja përmes postes e dërgoi në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjyqimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS C-IV-15-0293 të datës 19 tetor 2021, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të prishet Aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rigjykim ose të aprovohet padia si e bazuar, duke detyruar të paditurën të paguaj pagat e pa paguara për periudhën 2004-2013, në shumë prej 9.765,67 euro. Për më tepër në ankesë paditësja ka pohuar se me Aktgjykimin e ankimuar nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare dhe nuk janë vlerësuar me kujdes

provat e bashkangjitura me padinë. Tutje paditësja pohon se është shkelur neni 182 par 2 pika n) të LPK-së pasi që ky Aktgjykim nuk mund të ekzaminohet, është i pa kuptueshëm, kontradiktor dhe nuk përmban fare arsye për faktet vendimtare. Paditësja pohon se dispozitivi është i pa kuptueshëm, ngase Gjykata nuk dihet se çka ka vendos. Në dispozitiv është refuzuar ankesa si e pa bazuar, ndërsa në pjesën e arsyetimit në faqen 3 në pasuesin 5, gjykata thekson se e paditura në vendimin e goditur e as në mbrojtjen në përgjigje ndaj kërkesë padisë, nuk e ka kontestuar bazën dhe lartësinë e kërkesë padisë. Tutje paditësja pretendon se nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike pasi nuk janë vërtetuar faktet vendimtare në këtë çështje kontestimore e që Gjykata është dashtë të fokusohet. E paditura duke mos kontestuar asnjë provë të paditëses edhe lartësinë e pretenduar të kërkesës, ajo vetëm ka konstatuar se kërkesa është parashkruar. Prandaj detyra e Gjykatës së Shkallës së I-rë ka qenë që të vërtetohet a qëndron pretendimi i paditëses se kërkesa nuk është parashkruar apo se vendimi i të paditurës a është i drejtë dhe i bazuar në ligj. Tutje ajo pohon se është i gabuar konstatimi i Gjykatës se kërkesa e paditëses është e parashkruar në tërësi dhe si pasoj e kësaj ka zbatuar gabimisht edhe të drejtën materiale. Në fakt me dispozitën e nenit 387 të LMD-së është paraparë ndërprerja e parashkrimit kur debitori e pranon borxhin. Në këtë rast e paditura gjatë periudhës kontestuese ka bërë disa pagesa në formë të akontacionit kohë pas kohe dhe se me pagesat e tilla është ndërprerë rrjedha e parashkrimit të kërkesës. Tutje ajo pohon se nuk është i qëndrueshëm konstatimi i Gjykatës se nuk janë paraqit prova të besueshme për të mbështetur kërkesën e saj, kur vetë Gjykata në arsyetim ka konstatuar se çështja e lartësisë së kërkesës ka qenë jo kontestuese. Duke qenë se lartësia e diferencës në mes pagave të pa paguara asnjëherë nuk është kontestuar nga ana e të paditurës, por përkundrazi ka qenë jo kontestuese shuma e kërkuar prej 9.765,67 euro. Paditësja pohon se faktet të cilat nuk kundërshtohen nga ana e të paditurës nuk provohen, prandaj e paditura është e vetëdijshme se provat e prezantuar janë të vërteta dhe të bazuara në kontabilitetin e të paditurës. Ajo pohon se këto prova janë nxjerrë nga kontabiliteti i të paditurës përkatësisht nga kryesia dhe kryetari i sindikatës të cilat janë dorëzuar në origjinal në AKP. Në ankesë paditësja pohon se në rastet e tjera për kërkesa të ngjashme DHPGJS-ja e ka aprovuar kërkesën për paga dhe ajo

thirret në Aktgjykimin C-IV-15-0291 datë 12.04.2021, si dhe në rastin AC-I-16-0140 të datës 12.11.2020. Bashkë me këtë ankesë ajo bashkëngjit Aktgjykimet të cilat u referohet në ankesë.

Më datë 29 dhjetor 2021, AKP-ja e dorëzon një parashtrësë në DHPGJS dhe i përgjigjet ankesës së ankueses. Në këtë parashtrësë AKP-ja i kundërshton pretendimet ankimore të ankueses duke i konsideruara si të pabazuara në ligj dhe e mbështet në tërësi Aktgjykimin e ankimuar të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, duke e konsideruar si të drejtë dhe të ligjshëm. AKP-ja pohon se argumentet e saja i ka sqaruar mjaftueshëm në mbrojtje në ankesë, andaj ato nuk do të përsëriten nga se kjo do të jetë e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. Nga këto arsye AKP-ja kërkon që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me datë 10 nëntor 2022, Kolegji i Apelit me Aktvendimin AC-I-21-0764 e aprovon ankesën e paditëses si të bazuar, e anulon Aktgjykimin e ankimuar dhe padinë e kthen në rigjykim tek gjyqtari përkatës. Kolegji i Apelit ka arsyetuar se duke marrë për bazë faktin se kërkesa tek Autoriteti i Likuidimit është dorëzuar me datë 19 gusht 2014, atëherë del që pagat nga muaji gusht i vitit 2011 e deri në fundin e vitit 2013, nuk janë parashkruar pasi që është e qartë se ende nuk kishte kaluar afati 3 vjeçar i parashkrimit siç pretendon në mënyrë të gabuar Autoriteti i Likuidimit. Pagat e tjera të periudhës së mëhershme nga viti 2004 e deri në korrik 2011, janë parashkruar dhe për këtë pjesë të periudhës kohore, Kolegji i Apelit e mbështet konstatimin e dhënë të Autoritetit të Likuidimit se kërkesa është parashkruar. Tutje Kolegji i Apelit vëren se Shkalla e I-rë e ka refuzuar ankesën e paditëses dhe ka vërtetuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit për dy arsye kryesore, në njërin anë konstaton se paditësja nuk ka dorëzuar dëshmi që të ketë iniciuar ndonjë procedurë gjyqësore pranë organeve kompetente për pagat e kërkuara duke konsideruar se kërkesa është e parashkruar, e në anën tjetër Shkalla e I-rë konstaton se për periudhën e cekur NSH-ja e paditur i ka paguar pagat e pretenduara nga ana e paditëses të cilin konstatim e nxjerr në bazë të Raportit bankar të rrjedhjes së pagesave në llogarinë e tij në Raiffaisen Bank.

Kolegji i Apelit vëren se paditësja këmbëngulë që nuk janë paguar pagat e pretenduara në periudhën e cekur, përveç kohë pas kohe në formë të akontacioneve, gjë që paditësja pretendon se pagesat e kryera nuk ka qenë paga mujore por akontaicone të kohë pas kohshme. E paditura siç u tha më sipër kërkesën e ka refuzuar vetëm për shkak të parashkrimit e jo edhe për ndonjë bazë tjetër ligjore. Kolegji i Apelit nuk e mbështet konstatimin e dhënë të Shkallës së I-rë, se në periudhën e cekur janë kryer pagesat në emër të pagave të cilat paditësja i pretendon ndaj NSH-së, pasi që një konstatim i tillë ende nuk mund të mbështetet në prova bindëse për gjykatën dhe në prova të mjaftuara. Në këtë lëndë është e domosdoshme të vërtetohet që për periudhën gusht 2011-2013 për të cilën kërkesa për paga ende nuk është parashkuar, duhet tu jepet mundësia të dy palëve të sjellin prova të reja, e pastaj të nxirret konstatimi nëse janë paguar në tërësi ose jo pagat të cilat paditësja i pretendon ndaj NSH-së. Paditësja deri në këtë fazë të procedurës ajo ka dorëzuar kopjen e Librezës së punës e cila është e mbyllur me datë 06.09.2013, si dhe Njoftimin e AKP-së për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me datë 06.09.2013. Këto dy dëshmi flasin që ajo ligjërisht ishte në marrëdhënie pune në NSH deri në ditën e fillimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH-së, me datë 06.09.2013. Mirëpo këto prova ende nuk janë të mjaftuara për të aprovuar ankesën e saj. Nuk ka dëshmi konkrete në lëndë për lartësinë e pagave mujore të pretenduara nga ana e paditëses. Listat e pagave të cilat paditësja i ka sjellë me ankesë në Shkallën e I-rë nuk janë të protokolluara, nuk janë të nënshkruara dhe as të vulosura nga një autoritet gjegjës i NSH-së. Andaj këto prova nuk janë të besueshme për Gjykatën në mënyrë që të vërtetohet lartësia e pagesë mujore të paditëses.

Pas kthimit të lëndës në rigjykim, ajo regjistrohet me numrin e ri, C-IV-22-0361.

Me datë 06 dhjetor 2022, shkalla e I-rë e DHPGJS-së e lëshon një Urdhër për AKP-në, me të cilin kërkohet nga AKP-ja të sqaron sa kërkesa kreditore i ka paraqitur paditësja, dhe sa vendime janë marrë lidhur me ankuese në procedurën e likuidimit, të sqaron a ka paraqitur paditësja kërkesë për paga, për cilën periudhë dhe si është vendosur, të sqaron a ka paraqitur paditësja kërkesë për kompensim

për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, nëse po në cilën shumë dhe si është vendosur, si dhe të sqaron sa ka qenë paga mujore e paditëses gjatë periudhës kontestuese.

Me datë 28 dhjetor 2022, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë si përgjigje ndaj Urdhrit. Në këtë parashtresë AKP-ja pohon se paditësja ka paraqitur tri kërkesa kreditore, PRZ009-0251, lidhur me kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 807.84 euro, PRZ009-0255 për paga të papaguara në shumë prej 9,765.67 euro dhe PRZ009-0249 për paga të papaguara në shumë prej 807.84 euro. Tutje AKP-ja pohon se sipas rregullit bazik në bazë të nenit 7 të LPK-së, barra e provës bie mbi paditësen. AKP-ja në këtë parashtresë ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Bashkë me këtë parashtresë AKP-ja dërgon Listën e pagave për periudhën e cekur, formularët e kërkesave, fotokopjen e Librezës së punës, Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, Aktgjykimet e dy shkallëve të DHPGJS-së, tri Vendimet e Autoritetit të Likuidimit që i përkasin kësaj ankese lidhur me kërkesat kreditore të saj, dhe pasqyra tabelare të Raifezen Bank.

Me datë 02 shkurt 2023, shkalla e I-rë e DHPGJS-së me pikën **I** të dispozitivit të Aktgjyimit, C-IV-22-0361 e aprovon pjesërisht ankesën e paditësit si të bazuar, dhe e detyron të paditurën që të ja paguaj paditëses në emër të pagave të papaguara për periudhën shtator-dhjetor 2010 shumën prej 221.96 euro, për periudhën janar-dhjetor 2011, shumën prej 1,653.48 euro, për periudhën janar-dhjetor 2012 shumën prej 995.16 euro dhe për periudhën janar shtator 2013 shumën prej 1,884.96 euro, ose në shumën e përgjithshme prej 4,755.56 euro, që do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit. Me pikën **II** të dispozitivit të Aktgjyimit refuzohet pjesërisht ankesa si e pa bazuar, për pjesën e kërkesës përtej shumës së aprovuar. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se paditësja ka qenë punëtore e NSH-së deri me 06.09.2013, kur AKP-ja ja ka dërguar Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Paditësja ka paraqitur kërkesë kreditore për paga tek Autoriteti i Likuidimit

për periudhën 2004-2013, në shumë prej 9,765.67 euro, e cila kërkesë është refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se është parashkruar. Tutje shkalla e I-rë konstaton se AKP-ja nuk e ka kontestuar lartësinë e kërkuar të kompensimit në emër të pagave. AKP-ja në bazë të Urdhrit të lëshuar ka sjellë listat e pagave për periudhën e cekur, ku paga e paditëses nuk ka qenë e njëjtë nga viti në vitë, dhe ajo varijon prej 54.49 euro e deri 269.28 euro. Tutje shkalla e I-rë konstaton se kërkesa për pagesën e pagave është e bazuar për periudhën shtator 2010-shtator 2013, pasi që për këtë periudhë nuk ka parashkrim të kërkesës, marrë për bazë faktin se Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 06.09.2013, e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës. Tutje shkalla e I-rë konstaton se pagat tjera të periudhës së mëhershme janë parashkruar. Shkalla e I-rë konstaton se në bazë të provave të ofruara, paditëses pjesërisht i njihet e drejta në pagesën e pagave të papaguar për periudhën shtator 2010-shtator 2013, në shumën e përgjithshme prej 4,755.56 euro, ndërsa i refuzohet pjesa tjetër e kërkesës, për tej shumës së aprovuar, në bazë të nenit 372.1 të LMD-së, pasi që kjo pjesë e kërkesës është parashkruar.

Me datë 23 shkurt 2023, AKP-ja përmes postës e dërgon një ankesë të afatshme kundër pikës I të dispozitivit të Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-22-0369 të datës 07 shkurt 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar në pjesën aprovuese, të refuzohet ankesa e paditëses si dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontestit faktik të çështjes. Tutje AKP-ja pohon se Gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes i ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme, njëra që ndërlidhet me afatin për parashtrimin e kërkesave i cili afat i përket procedurës së dorëzimit të dëshmisë së kërkesës dhe afati i dytë ka të bëjë me natyrën (meritat e të drejtës e që ka të bëjë me afatin e parashkrimit të kërkesës e që në këtë rast është 3 vite në bazë të nenit 608 të Ligjit të punës së Bashkuar. Tutje AKP-ja pohon se njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës i dërguar tek paditësi ka pas për qëllim të informon atë se ai ka të drejtë të parashtroj kërkesë pranë AKP-së dhe se ky

njoftim nuk i mbron të drejtat e tij dhe nuk siguron mjete ligjore që ai ka në dispozicion. Tutje AKP-ja pohon se kërkesa e paditëses për paga të papaguara për periudhën 2004-2013, është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar pasi që ajo nuk ka dorëzuar dëshmi ti ketë kërkuar këto paga brenda 3 viteve pas datës së privatizimit të NSH-së që ka ndodhë me datë 06 shtator 2013. AKP-ja në ankesë ka kërkuar nga gjykata, që të lëshohet edhe njëherë në shqyrtimin e meritave, dhe të merre në konsideratë argumentet e ngritura të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 28 shkurt 2023, paditësja përmes postës e dërgon një ankesë të afatshme kundër pikës **II** të dispozitivit të Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-22-0369 të datës 07 shkurt 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar në pjesën refuzuese, dhe të aprovohet pjesa tjetër e kërkesës padisë si e bazuar. Për më tepër në ankesë paditësja ka pohuar se pjesa refuzuese e Aktgjykimit ka të meta, për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dhe është i përfshirë me shkelje procedurale. Ajo pohon se Aktgjykimi në pjesën refuzuese është kontradiktor, i pa kuptueshëm dhe nuk përmban arsye për faktet vendimtare. Tutje paditësja pohon se gabimisht janë vërtetuar faktet në drejtim të parashkrimit të kërkesës. Ajo pohon se gjatë periudhës për të cilën është refuzuar kërkesëpadia, e paditura ka bërë pagesa të pagave, të emërtuara si akontacione, pro këto janë dhëniet që janë bërë në emër të pagave, kohë pas kohe. Ajo pohon se me pagesa të tilla pa dyshim është ndërprerë parashkrimi i kërkesës, dhe në këtë drejtim janë praktikat e gjykatave në Kosovë. Paditësja pohon se ky fakt i pagesës vërtetohet me raportet nga llogaria bankare në R B, ku janë bërë pagesat kohë pas kohe. Paditësja pohon se lartësia e diferencës së pagave për periudhën kontestuese, nuk është kontestuar asnjëherë nga e paditura. Paditësja pohon se ky fakt vërtetohet nga Deklarata e përbashkët e dhënë me datë 06.10.2022 nga ish arkatari i NSH-së O Sh, nga ish shefi i kontabilitetit S Sh dhe ish Drejtori R A. Kjo deklaratë do të bashkangjitet me ankesë. Paditësja ka kërkuar që të merret një vendim i drejtë dhe i ligjshëm, e të ndryshohet pika II e dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar.

Me datë 07 prill 2023, AKP-ja e dorëzon një parashtresë dhe përgjigjet në ankesën e paditëses. Në këtë parashtresë AKP-ja ka pohuar se Aktgjykimi i Shkallës së I-rë është i bazuar në ligj dhe në prova, dhe se ky Aktgjykim duhet të vërtetohet nga Kolegji i Apelit. Tutje AKP-ja pohon se pretendimet e veta dhe argumentet ligjore në mënyrë të mjaftueshme i ka qartësuar në mbrojtjen në padi dhe në procedurat e mëvonshme, andaj përsëritja e këtyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. Nga këto arsye AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa i e pa bazuar, dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me datë 13 prill 2023, paditësja e dorëzon një parashtresë dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Në këtë parashtresë paditësja ka pohuar se në bazë të nenit 387 të LMD-së parashkrimi ndërpritet kur debitori pohon borxhin, dhe pohimi i borxhit bëhet duke dhënë deklaratë kreditori apo edhe në mënyrë indirekte siç është dhënia e kësteve, pagimi i kamatës dhe dhënia e sigurimit. Tutje paditësja pohon se e paditura për vitin 2004 deri 2013 ka bërë pagesa paga në formë të akontacionit kohë pas kohe dhe se me pagesat e tilla ajo e ka ndërprerë parashkrimin. Pagesat vërtetohen në bazë të llogarisë bankare të paditëses në R B, ku ato pagesa janë bërë kohë pas kohe. Nga këto arsye ka kërkuar që të refuzohet ankesa e të paditurës si e pa bazuar.

Me datë 25 prill 2023, paditësja e dorëzon një parashtresë në DHPGJS të cilën e quan plotësim ankese, e me të cilën parashtresë ajo e dorëzon një kopje të Aktgjykimit të një rasti tjetër C-IV-22-0218, të datës 13 prill 2023.

Arsyetimi ligjor:

Ankesat refuzohen si të pabazuara.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Ankesa e Paditëses

Kolegji i Apelit vëren se paditësja me datë 19 gusht 2014, e ka dorëzuar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit për pagesën e pagave të pa paguara për periudhën nga viti 2004 e deri në vitin 2013, nga NSH " Lavërtari Blegtori", Prizren (në likuidim), në shumë prej 9.765,67 euro. Kjo kërkesë është refuzuar si e pa vlefshme nga ana e Autoriteti të Likuidimit, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Duke marrë për bazë faktin se paditëses i është ndërprerë marrëdhënia e punës në NSH me datë 06.09.2013, që vërtetohet në bazë të Njoftimit të AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës, dhe në bazë të Librezës së punës e mbyllur me 06.09. 2013, atëherë dele që paga nga shtatori 2010 e deri në shtator 2013, nuk janë parashkruar, pasi që ky Njoftim për ndërprerje të marrëdhënies së punës e ka ndërprerë rrjedhën e parashkrimit të kërkesës. Pagat tjera të kërkuara nga paditësja për periudhën nga viti 2004 e deri në gushtë 2010, janë parashkruar.

Këtë gjendje faktike me të drejtë e ka konstatuar edhe shkalla e I-rë e DHPGJS-së, të cilën e mbështet edhe Kolegji i Apelit.

Kolegji i Apelit vëren se paditësja këmbëngulë që nuk janë paguar diferenca e pagave të pretenduara ndaj NSH-së në periudhën e cekur. Ajo vet ka pohuar se kohë pas kohe në formë të akontacioneve, ka marrë të holla nga NSH-ja, gjë që

paditësja pretendon se pagesat e kryera kanë qenë të kryera në emër të pagave. Paditësja në fakt kërkon diferencën e mbetur të pagës së pa paguar të pagës mujore.

Raportet nga llogaria e R B të cilat i ka sjellë AKP-ja, vërtetojnë se paditësja ka marrë kohë pas kohe në periudhën e cekur shuma përkatëse, të cilën paditësja e quan pjesë të pagës mujore, ose akontacioni i pagës, gjë që gjykata nuk është e bindur nëse ishte pjesë e pagës, apo ndonjë ndihmë materiale e kohëpaskohshme të dhënë nga NSH-ja për punëtorët e saj.

Edhe nëse ajo çka ka marrë paditësja nga NSH-ja, mund të quhet pjesë e pagës mujore që e ka kryer NSH-ja, gjë që për këtë nuk prova bindëse që ishte pagë mujore, kjo nuk nënkupton ndërprerje të parashkrimit në kuptim të nenit 387 të LMD-së, siç pretendon paditësja.

Siç ka konstatuar saktë shkalla e I-rë, në bazë të dispozitës së nenit 87 të Ligjit të punës dhe nenit 353.1 të LMD-së në zbatim, pagat mujore hyjnë në nocionin e "dhënieve periodike", dhe çdo pagë mujore parashkruhet veç e veç. Prandaj parashkruhet edhe pjesa e pretenduar e pagës mujore, e mbetur e pa paguar.

Paditësja në përdhën e cekur, çdo pjesë të pretenduar të pagës mujore, që sipas paditëses NSH-ja i ka mbetur borxh, është dashtë ta kërkojë në gjykatë brenda tri viteve, dhe të mos lejoj parashkrimin e kërkesës.

Në këtë rast është i drejtë konstatimi i shkallës së I-rë se pagat e pretenduara nga viti 2004-gusht 2010, janë parashkruar, pasi që është e qartë se paditësja nuk ka sjellë prova në gjykatë se ato i ka kërkuar brenda tri viteve.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se paditësja me ankesën në shkallën e dytë e ka sjellë një Deklaratë të përbashkët të ish Drejtorit, ish kontabilistit dhe ish Arkatarit të NSH-së, me të cilën ajo pohon se është provë, në bazë së cilës vërtetohet se NSH-ja asaj i ka mbetur borxh për diferencën e pagave të papaguara nga viti 2004-2013. Kjo Deklaratë është sjellë vetëm në procedurë ankimore, ajo si e tillë nuk

mund të konsiderohet as provë e vlefshme, me që nuk është deklaratë e dhënë para gjykatës, dhe as nuk mund të quhet provë e dëshmisë së dëshmitarëve. Andaj nga këto arsye, kjo Deklaratë nuk është marrë për bazë gjatë shqyrtimit të meritave të ankesës së paditëses.

Prandaj nga këto arsye, ankesa e paditëses refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet pika **II** e dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar të shkallës së I-rë, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Ankesa e AKP-së

Kolegji i Apelit vëren se Paditësja me ankesën në shkallën e I-rë e ka dorëzuar kopjen e Librezës së punës e cila është e mbyllur me datë 06.09.2013, si dhe Njoftimin e AKP-së për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me datë 06.09.2013. Këto dy dëshmi flasin që ajo ligjërisht ishte në marrëdhënie pune në NSH deri në ditën e fillimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH-së, me datë 06.09.2013.

Kolegji i Apelit vëren se në bazë të urdhrit të shkallës së parë, e paditura me parashtresën e datës 28 dhjetor 2022, ka dërguar Listën e pagave për periudhën e cekur. Bazuar në të dhënat nga këto lista, si dhe në faktin se AKP-ja nuk e konteston lartësinë e kompensimit, shkalla e I-rë në mënyrë të drejtë e ka kalkuluar borxhin e NSH-së në emër të pagave të pa paguara, dhe me të drejtë pjesërisht e ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit për periudhën shtator 2010-shtator 2013, në shumë prej 4,755.56 euro, që duhet të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Tutje Pretendimi i AKP-së se është parashkruar kërkesa për paga për tërë periudhën nga viti 2004-2013, është pretendim i pa bazuar, dhe këtë pretendim nuk e ka mbështetur me të drejtë shkalla e I-rë, e nuk e mbështet as Kolegji i Apelit.

Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës, siç ka konstatuar shumë herë Kolegji i Apelit në jurisprudencën e tij të deritanishme, e ndërpre në parashkrimin e kërkesës.

Andaj nga këto arsye, ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet pika **I** e dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

AKP-ja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 24 mars 2023, në shumë prej 100 euro, ndërsa paditësja me datë 29 mars 2023 në shumë prej 30 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendosë nga Kolegji i Apelit me datë 11 janar 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
